

Projekt Propozim

Ndërtimi i murit rrethues dhe sistemime të kompleksit të shkollave në Lagjen “Beslidhja”

Bashkia Lezhë

1. Të dhëna të përgjithshme

Aplikanti/ët:	Bashkia Lezhë
Personi/at e kontaktit:	Arben Dodaj:Drejtor i Urbanistikës (urbanistika@lezha.org) Dile Nikolla:Programim Zhvillimi (pzhvillimi@lezha.org)
Titulli i projektit	Ndërtimi i murit rrethues dhe sistemime të kompleksit të shkollave në Lagjen “Beslidhja”
Vendndodhja	<i>Bul. Papa Gjon Pali II, Lagjia “Beslidhja” Lezhë.</i>
Buxheti i kërkuar nga dldp	39999 €
Kodi i projektit në strategjinë e zhvillimit lokale apo rajonale	
Data e dorëzimit (për tu plotësuar nga stafi i dldp)	
Numri i projektit (për tu plotësuar nga stafi i dldp)	

2. Një përmbledhje e projekt-propozimit

Ky projekt do të implementohet nga Bashkia Lezhë për një periudhë kohore 8 mujore. Me këtë projekt Bashkia Lezhë synon të rrisë elementet e sigurisë për komunitetin e nxënësve dhe stafeve të këtij kompleksi shkollash, duke përmirësuar infrastrukturën me të gjitha elementet që rrisin sigurinë dhe mbarëvajtjen e procesit edukativ në kompleksin e 4 shkollave që ndajnë të njëjtin oborr. Gjithashtu do të përmirësohet dhe mjedisi sportiv në oborr, që të ofrojë mundësi për të kaluar kohën e lirë në funksion të një jete të shëndetshme dhe të aksesueshme për të gjithë. Një fushatë ndërgjegjësuese për mirëmbajtjen e këtij mjedisi dhe kundër fenomeneve negative në të njëjtën kohë, që të rinjtë e këtyre shkollave janë prehtë, do të jetë një element tjetër me rëndësi i këtij projekti dhe do të vazhdojë dhe në të ardhmen.

Objektivat specifik:

- Krijimi i një mjedisi të përshatshëm në oborrin e kompleksit të shkollave në lagjen “Beslidhja” nëpërmjet rrethimit, ndriçimit dhe krijimit të mjediseve sportive dhe argëtuese për nxënësit dhe komunitetin në tërësi.
- Ndërgjegjësim i nxënësve dhe personelit mësimdhënës për mirëmbajtjen e mjediseve të krijuara dhe kundër fenomeneve negative si konflikti, droga dhe trafikimi njerëzor.
- Rritja e kapaciteteve të stafit të bashkisë për menaxhimin e projekteve.

Bashkia Lezhë për zbatimin e këtij projekti do kontraktojë kompaninë që do shpallet fituese në një tender të hapur dhe transparent për të gjithë. Kjo kompani do të mbulojë zbatimin e ndërhyrjeve në infrastrukturë. Gjithashtu, duke qënë se ky projekt ka dhe elemente sociale të ndërthurur, Bashkia Lezhë do ngarkojë departamentet përkatëse për të siguruar implementimin e fushatës ndërgjegjësuese si për

mirëmbajtjen ashtu dhe ndaj fenomeneve negativë që kanë ardh ose janë shtuar në numër nga mungesa e infrastrukturës sociale si: muri rrethues, ndriçimi, mjedis sportiv dhe i gjelbëruar. Bashkia Lezhë për realizimin e fushatave ndërgjegjësuese ka një histori të mirë suksesi me vullnetarët e Parlamentit Rinor, që kanë qënë një faktorë pozitiv për ndërgjegjsimin në të gjitha nivelet mbi çështjet mjedisore, buxhetimin me pjesëmarrje etj. Ky grup vullnetarësh që funksionon rregullisht në Lezhë do të shërbejë në edukimin bashkëmoshatare(peer- educator). Nga procesi i vleresimit të nevojave duke përdorur forma të ndryshme si: takime formale dhe informale me grupet e interesit, statistika zyrtare nga intitucionet (Policia/DA/Drejtoria e Shëndetit Parësor/Bashkia) ka listuar këto fenomene negative; Sherre banale midis studentave aty dhe te huaj që kanë gjetë liri hyrje (konflikte djem-vajza), përdorim lëndësh narkotike. Mjedisi i hapur dhe në errësire totale ka lehtësuar hyrjen e shpërndarësve të drogave dhe ka rrit numrin e përdoruesve për studentat e shkollave aty dhe ka rritur riskun për trafikim njerëzor sidomos të vajzave konviktore që jetojnë tërë kohën aty.

Projekti është dezignuar me kujdes që të mos krijojë barriera sociale dhe përjashtime të grupeve vulnerabel. Target grupi kryesor do të jenë të rinjtë studentë të shkollave të mesme dhe 9-vjeçare aty, ku në mesin e tyre ka persona me aftësi të kufizuara në ecje, shikim dhe paralizë lokale dhe prapambetje mendore.

Rezultate që priten nga ky projekt janë:

Mjedis fizik i sigurt rrethues në kompleksin e shkollave;

Infrastrukturë e përmirësuar e oborrit të shkollave;

Mjedis sportiv më cilësor për nxënësit dhe i aksesueshëm për personat me aftësi të kufizuara;

Të rinj të sensibilizuar për: mirëmbajtjen e mjedisit të krijuar; shmangien dhe zgjidhjen e konflikte ndermoshatare, rreziqet e përdorimit të duhanit dhe drogave, rreziqet e trafikimit njerëzor.

Aktivitetet kryesore të këtij projekti do të jenë:

1. Prokurimi
2. Realizimi i murit rrethues dhe sistemimeve (Punime gërmimi, derdhje betoni, mure dekorative, kangjella hekuri, punime shtresa inerte dhe betoni për terrenet sportive, vendosja e ndriçuesve , punime ndriçimi (linja dhe shtylla metalike), vendosja e aksesorëve dekorativë.
3. Ndërtimi i mjediseve sportive (Punime sistemim të sipërfaqes së oborrit, vendosja e pajisjeve specifike etj.
4. Supervizimi – supervizimi i punimeve kryhet nga specialistë të licencuar të caktuar nga Bashkia Lezhë, në bashkëpunim me specialistët e dldp-së sipas kushteve të caktuara në kontratën me punëmarrësin.
5. Marrja në dorëzim
6. Fushatë ndërgjegjësuese me nxënësit e shkollave të projektit për mirëmbajtjen e mjedisit dhe kundër fenomeneve negativë si konflikti/drogat/trafikimi njerëzor.
7. Trajnimi i stafit të bashkisë për menaxhimin e projektit sipas standarteve të vendosura nga donatori.
8. Vlerësimi i kënaqësisë së komunitetit për investimin e kryer.

Projekti ka një vlerë totale prej **62157 €**, nga të cilat **22155 €** janë kontribut i Bashkisë Lezhë, ndërsa **39999 €** kërkohet nga intercooperacioni Zvicëran në Shqipëri.

3. Analiza e situatës (jo më tepër se 2 fq.)

Projekti “Ndërtimi i murit rrethues dhe sistemime të kompleksit të shkollave në lagjen “Besëlidhja” është në hamoni të plotë më strategjitë e bashkisë dhe me projekt buxhetin afatmesëm të saj si dhe me Strategjinë Rajonale të Zhvillimit, më saktë Kapitulli II “Shtrirja e arsimit baze për të gjithë” si dhe me

politikat e qeverisë shqiptare për arsimin. Gjithashtu dhe me strategji Kombëtare si ajo e Fëmijëve, kapitulli V “ZHVILLIMI I FEMIJES” si dhe me Strategjinë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara, konkretisht Objektiv 6: Mbështetja e personave me aftësi të kufizuara për një jetë cilësore në komunitet .

Projekti kontribon në përmirësimin e infrastrukturës sociale të qytetit Lezhë, funksion i drejtpërdrejtë i Bashkisë Lezhë, dhe që ndikon në rritjen e cilësisë së jetës, prioritet strategjik i Bashkisë. Kjo bashki ka në administrim të saj 275 ha sipërfaqe, popullsia aktuale e qytetit është 29002 banorë me tendencë drejt rritjes. Qyteti gjendet në kilometrin e 60 të rrugës kombëtare SH1 Tiranë Shkodër, 8 km larg portit të Shëngjinit dhe 15 km nga A1 Durrës-Kukës. Lezha është qendra kryesore ekonomike e qarkut të Lezhës. Në qytet gjendet administrata e Këshillit të Qarkut dhe e Prefektit të Qarkut Lezhë, dhe popullsia e qytetit është një përzierje e të ardhurve nga të gjitha zonat e veriut të Shqipërisë. Tendanca e qytetit është për një mirëqënie në rritje çka ka sjellë edhe rritjen e numrit të popullsisë dhe zgjerimin e zonës qytetare edhe në zonat përreth qytetit që nuk janë në administrim të Bashkisë. Në infrastrukturën sociale Bashkia Lezhë ka realizuar një sërë projektesh. Kështu, sistemim, asfaltim, ndriçim dhe gjelbrim blloku prej 11,2 ha ne lagje “Beslidhja” –faze III-te, sistemim i bllokut të banimit pranë lumit Drin, blloku I & II-te, faza II-te, sistemim në lagjen " Gurra " Sistemim në lagjen e Spitalit, sistemim i lagjes “Nënë Tereza “

Në planet e saj të ardhshme afatmesme bashkia ka si prioritet përmirësimin e infrastrukturës si asfalt, trotuare, ndriçim, kanalizime, gjelberime, etj për të rritur cilësinë e jetës së qytetarëve.

Ndërmarrja e këtij projekti është si rezultat i një situate të papërshtatshme në kompleksin e shkollave: Hydajet Lezha, Kolin Gjoka, Kosova, Qendra Ditore”Trendafilat”, konvikti i vajzave të shkollës profesionale K.Gjoka, që ndajnë të njëjtin mjedis rrethues. Mungesa e një muri rrethues për kompleksin e shkollave që ndajnë të njëjtin oborr ka sjellë probleme serioze për jetën e nxënësve dhe mesuesve që frekuentojnë këtë shkollë, të cilat kanë shkaktuar pasiguri dhe cënim të mbarvajtjes së mësimdhënies në shkolla. Kështu, në vazhdimësi janë evidentuar incidente të ndryshme shoqëruar me përdorim armësh në ambientet e këtij kompleksi shkollash. Sipas një informacioni zyrtar marrë nga Drejtoria Rajonale e Policisë vetëm për vitin 2011 janë evidentuar 24 raste incidentesh në gjimnazin” Hydajet Lezha”, 13 raste në shkollën profesionale “Kolin Gjoka” dhe 19 në shkollën 9-vjeçare “Kosova”. Vajzat e konviktit (35) janë shpesh të riskuara për trafikim njërëzor si rezultat i hyrjes së makinave të pakontrolluara. Shkaqet e këtyre incidenteve, sipas specilistëve të policisë kanë qënë për motive të dobëta, sherre të çastit, konflikte që lindin si rezultat i problemeve të moshës së adoleshencës në marrëdhëniet vajza – djem, ku shpesh kanë qënë persona të tretë jashtë shkolle që kanë hyrë në ambientet e shkollave dhe kanë shkaktuar konflikte, ku janë përdor armë zjarri dhe të ftohta, kapsolla dhe shashka që prishin qetësinë. Gjithashtu ka patur raste të hyrjes së shpërndarësve të lëndëve narkotike, si dhe përdorim lëndësh narkotike në mjedise të oborrit të shkollës si rezultat i lëvizjeve të pakontrolluara dhe mungesës së ndriçimit në gjithë territorin e oborrit të përbashkët dhe mungesës së mjediseve sportive në shërbim të kohës së lirë. Ky mjedis nuk e fasiliton jetën për personat me aftësi të kufizuara si: persona që ecin me karrocë, persona të verbër, persona me paralize lokale dhe prapambetje mendore që frekuentojnë shkollat ose qëndrën Trëndafilat në këtë kompleks.

Projekti i propozuar synon të rrisë elementet e sigurisë për komunitetin e nxënësve dhe stafeve të këtij kompleksi shkollash, duke përmirësuar infrastrukturën me të gjitha elementet që rrisin sigurinë dhe mbarëvajtjen e procesit edukativ në kompleksin e 4 shkollave që ndajnë të njëjtin oborr. Gjithashtu do të përmirësohet dhe mjedisi sportiv në oborr, që të ofrojë mundësi për të kaluar kohën e lirë në funksion të një jete të shëndetshme me elementet të perfshirjes sociale (rampa dhe bume për të verberit)

4. Analiza e grupeve që ndikohen nga projekti; Grupet e synuara dhe përfituesit (jo më tepër se 1 fq.)

Përfituesit e drejtpërdrejtë të projektit do të përfshijnë:

Gjithsej, 3161 nxënës dhe mësues, nga të cilët 1653 femra. Në përgjithësi, ata do të përfitojnë siguri dhe një mjedis social kulturor e edukativ më të përshtatshëm. Më konkretisht, përfituesit përfshijnë:

- 2353 nxënës të dy shkollave të mesme, nga të cilët 1223 janë vajza dhe 1133 djem
- 621 nxënës të shkollës 9- vjeçare, nga të cilët 280 janë vajza dhe 341 janë djem.
- 35 fëmije, nga të cilët 12 vajza dhe 23 djem të qëndrës ditore për fëmijët me zhvillim të ngadaltë, të cilët përfitojnë një infrastrukturë fizike të përshatshme me nevojat e tyre.
- 149 punonjës, nga të cilët 113 gra dhe 25 burra, të cilët do të punojnë në një mjedis më të qetë nga ndikimi i faktorëve të jashtëm.
- 2 persona me aftësi të kufizuar në ecje me karrocë, do të përfitojnë nga mjedisi i përbashkët në përshatje me nevojat e tyre.
- 4 persona me kufizim në shikim do të përfitojnë mundësi lëvizje dhe orientimi në këto oborre.

Përfituesit indirekt do të përfshijnë:

- Familjet e nxënësve dhe mësuesve që frekuentojnë këto shkolla dhe konviktin.
- Komuniteti në tërësi i Qarkut Lezhë

5. Qëllimi dhe objektivat specifike të projektit (jo më tepër se 1 fq.)

Qëllimi:Projekti do të kontribojë në rritjen e sigurisë në shkolla dhe parandalimin e fenomeneve negative si konfliktet, droga, trafikimi njerzror.

Në këtë drejtim do të kontribojnë edhe projekte të tjera. Në vitin 2009 Bashkia Lezhë ka përfituar nga dy projekte të Bankës Botërore në kuadër të programit “Cilësi dhe Barazi në Edukim” për ndërtimin e dy shkollave në qytetin e Lezhës, një shkollë 9-vjeçare dhe një shkollë e mesme të reja. Ndërkohë që Bashkia Lezhë me fondet e veta dhe me ndihmë nga partnerë italianë nga Komuna e Bolzanos në Itali po rristrukon edhe një shkollë tjetër 9-vjeçare të cilat pritet të jenë gati për mësim duke vazhduar që nga fillimi i vitit të ardhshëm. Kjo do t'i vinte shumë në ndihmë qytetit të Lezhës dhe aftësisë së tij për të rritur cilësinë e edukimit në një qytet që në katër vite ka katërfishuar popullsinë e tij. Bashkia do të kontribojë në ndërtimin e infrastrukturës fizike për personat me aftësi të kufizuara si rampa, etj

Objektivat:

- Krijimi i një mjedisi të përshatshëm në oborin e kompleksit të shkollave në lagjen “Beslidhja” nëpërmjet rrethimit, ndriçimit dhe krijimit të mjediseve sportive dhe argëtuese për nxënësit dhe komunitetin në tërësi.
- Ndërgjegjësim i nxënësve dhe personelit mësimdhënës për mirëmbajtjen e mjediseve të krijuara si dhe kundër fenomeneve negative si konflikti, droga dhe trafikimi.
- Rritja e kapaciteteve të stafit të bashkisë për menaxhimin e projekteve

6. Rezultatet e pritshme (jo më tepër se 1 fq.)

Rezultati	Treguesit	Mjetet e verifikimit
Rezultati 1: Mjedis fizik i sigurtë rrethues në kompleksin e shkollave	485 metra mur rrethues	Inventari i bashkisë, pranë zyrës së Financës. Vizita në vend Foto para dhe pas projektit
Rezultati 2: Infrastruktura e përmirësuar e oborrit të shkollave	5 ndriçues; 5 rampa; 290 m ² trotuar, 2000 m ² sipërfaqe e gjelbëruar	Inventari i bashkisë, pranë zyrës së Financës. Vizita në vend Foto para dhe pas projektit
Rezultati 3: Mjedis sportiv më cilësor për nxënësit dhe i aksesueshëm përsonat me aftësi të kufizuara	1000 m ² terren sportiv, i cili përfshin mundësira për lojra basketbolli, minifutbolli, volejboli 1 kampionat lojrash në vit në mes nx. të kompleksit të shkollave . Numri i aktiviteteve planifikuar cdo vit nga shkollat dhe grupet e tjera të marginalizuara.	Plan aktivitet e shkollave dhe drejtorive përkatëse të Bashkisë Lezhë.
Rezultati 4: Të rinj të sensibilizuar për: <ul style="list-style-type: none"> • Mirëmbajtjen e mjedisit të krijuar • shmangien dhe zgjidhjen e konflikteve ndërmoshatare. • rreziqet e përdorimit të duhanit dhe drogave • rreziqet e trafikimit njerëzor 	70% nga 3012 përfitues direkt të seancave sensibilizuese do jenë të sensibilizuar për mirëmbajtjen e mjedisit si dhe 80% e personave pjesëmarrës në 10 seancat sensibilizuese me specialist nga antidroga dhe shëndeti parësor, kanë njohuri të mira ose shumë të mira lidhur me informacionin e dhënë si: mbi rreziqet dhe masat parandaluese të përdorimit të lëndëve narkotike dhe zgjidhjen e konflikteve 70% nga 1451 përfituese gra e vajza gjithsej, ku 80% e personave pjesëmarrës në 2 seancat informuese me specialist nga antitrafikimi, do të jenë të informuara për rreziqet dhe mënyrën për tu mbrojtur nga rreziku i trafikimit njerëzor.	Liste prezencë në takime, trainime, foto etj. Rezultatet e pyetsorëve për nxënësit Listë prezencë në takime, trainime, foto etj. Rezultatet e pyetsorëve për nxënësit
Rezultati 5: Reduktimi dhe	Zvogëlimi i rasteve të	Raportet e Policisë së

parandalimi i fenomeneve negative brenda oborrit të shkollave si konflikti, droga, trafikimi, e keqbërësve-ndaj mjedisit të përmirësuar .	dëmtimeve të mjedisit nga keqbërësit Zvoglimi i rasteve të hyrjes së shpërndarsve të drogave të ndryshme. Zvoglimi i përdoruesve të drogave të ndryshme Zvoglimi i numrit të konflikteve, 35 nxënës të konvikteve të sensibilizuar për rrezikun e trafikimit njerëzor.	shtetit/Bashkiake dhe rojeve të shkollave; Raporte të drejtuesve të konviktit Poster
Rezultati 6: Staf i bashkisë i aftë për të menaxhuar projekte sipas kërkesave specifike të donatorëve të ndryshëm.	2 anëtarë stafi të trajnuar për menaxhimin e projekteve sipas kërkesave specifike të DLDP	Raporte të ofruesve të trajnimeve

7. Aktivitetet e projektit dhe zbatimi (jo më tepër se 3 fq.)

7.1 Prokurimi

- 7.1.1 Hartimi i specifikimeve teknike. Specialistët e Drejtorisë së Urbanistikës:ing.Arben Dodaj,ark.Eris Bejo dhe konsulente e jashtme nga Ing.elektrik Nikoll Hasni në bashkëpunim me stafin e dldp dhe Ekipin e Prokurimeve Publike në Bashkinë Lezhë do të hartojnë specifikimet teknike të projektit. Aktualisht po punohet për specifikimet teknike. Pritet përfundimi i prokurimit brenda një periudhe prej 40 ditësh me marrjen e miratimit të projektit.
- 7.1.2 Prokurimi online. Bashkia Lezhë pritët të kryejë prokurimin online brenda afateve të nevojshme nga gjetja e financimeve për realizimin e këtij muri rrethues.
- 7.1.3 Lidhja e kontratës. Në momentin e shpalljes së fituesit të Tenderit Publik nga ana e Bashkisë Lezhë lidhet kontrata dhe fillohen punimet nga kompania fituese.

7.2 Realizimi i murit rrethues dhe sistemimeve

- 7.2.1 Punime gërmimi
- 7.2.2 Derdhje betoni
- 7.2.3 Mure dekorative
- 7.2.4 Kangjella hekuri
- 7.2.5 Punime shtresa inerte dhe betoni për terrenet sportive
- 7.2.6 Vendosja e ndriçuesve
- 7.2.7 Punime ndriçimi (linja dhe shtylla metalike)
- 7.2.8 Vendosja e aksesorëve dekorative
- 7.2.9 Trotuar betoni me brez të gjelbër (brezi gjelbër në trotuarë dhe gjelbrimi i detajuar në planin e sistemimit do të realizohen dhe mirëmbahen Drejtoria e Shërbimeve Publike të Bashkisë Lezhë)

7.3 Ndërtimi i mjediseve sportive

- 7.3.1 Punime sistemim të sipërfaqes së oborrit
- 7.3.2 Vendosja e pajisjeve specifike etj (vijëzimi i fushave dhe mirëmbajtja do të realizohet nga drejtoria e shërbimeve të bashkisë Lezhë)
- 7.4 Supervizimi – supervizimi i punimeve kryhet nga specialiste të licensuar të caktuar nga Bashkia

Lezhë, në bashkëpunim me specialistët e dldp-së sipas kushteve të caktuara në kontratën me punëmarrësin.

7.5 Marrja në dorëzim

7.5.1 Kolaudimi i objektit

7.5.2 Marrja në dorëzim nga Bashkia Lezhë

7.6 Fushatë ndërgjegjësuere me nxënësit e shkollave të projektit për mirëmbajtjen dhe kundër fenomoneve negative.

7.6.1 Postera me mesazh për mirëmbajtjen e mjedisit të përbashkët nëpër shkollat e kompleksit, përgatitur nga vullnetarët e Parlamentit Rinor, Qeveritë e Nxënësve dhe bordet e prindërve.

7.6.2 3 Seanca informuese për rreziqet e drogave me nxënësit e shkollave në bashkëpunim me specialistë të antidrogës të policisë së shtetit (1 për secilën shkollë)

7.6.3 3 trajnime për qeveritë e nxënësve për cdo shkollë për zgjidhjen e konflikteve me psikologët e shkollave (1 për cdo shkollë)

7.6.4 3 Takime informuese me specialist të anti trafikimit me psikologët e shkollave nëpër klasat e shkollave përfituese sipas një grafiku miratuar nga drejtoritë e shkollave (1 për secilën shkollë). Per grafikun e këtyre aktiviteteve shiko **anex 1**.

7.7 Trajnimi i stafit të bashkisë.

Trajnimi për menaxhimin e projekteve dhe asistencë teknike për shkrimin e projektit. Gjithsej 5 ditë, përkatësisht 3 ditë trajnim dhe 2 ditë konsulencë për shkrimin e projektit. Organizata trajnuese ANTTARC

Seminar tematik për projektet e infrastrukturës. 1 ditë organizuar nga DLDP dhe ofruesit e seminarit tematik.

Trajnimi për monitorimin dhe raportimin e projektit. Gjithsej 3 dite, 1 ditë trajnim dhe 2 ditë asistencë teknike për shkrimin e raportit përfundimtar.

7.7 Vlerësimi i kënaqësisë së komunitetit për investimin e kryer

Përgatitja e pyetsorëve nga specialistë të Dldp dhe Bashkisë

Realizimi i anketimit të komunitetit në bashkëpunim shkollat e kompleksit.

Raportimi i rezultateve-tek donatori, këshilli bashkiak dhe kryetari.

Në mënyrë të përmbledhur grafiku i aktiviteteve paraqitet si më poshtë:

Aktiviteti	1	2	3	4	5	6	7	8	Organizata përgjegjëse
Prokurimi									Bashkia Lezhë, njësia e prokurimit dhe ko
Kontraktimi i punimeve									NJQV-ja, Kryetari
Zbatimi i punimeve									Kontraktori, Supervizori
Marrja në dorëzim									NJQV-ja, kolaudatori dhe supervizori
Ndërgjegjësimi i komunitetit të nxënësve.									Bashkia Lezhë, Drejtoritë e shkollave, Poli
Trajnimi i stafit të bashkisë									DLDP
Vlerësimi i kënaqësisë së komunitetit për shërbimin									Bashkia Lezhë, Drejtoria e Arsimit, Kulturë

8 Mënyra e organimit të prokurimit (jo më tepër se 1 fq.)

Prokurimi do të kryhet mbështetur në ligjin nr 9643 datë 20.11.2006 “ Për prokurimin publik “i ndryshuar . Mënyra e prokurimit do të jetë i hapur me mjete elektronike . Nga specialistet e Drejtorise se Urbanistikes pergatitisin dokumentacioni tekniko-ekonomik i tenderit, i cili perbehej nga projekti teknik, specifikimet teknike dhe preventivi me te gjitha zerat e punimeve qe do te kryheshin. Sipas urdherit te prokurimit nga ana e Kryetarit te Bashkise percaktohet fondi limit pa Tvsh, objekti i prokurimit, procedura e prokurimit dhe njesia e prokurimit.Dhe po me urdher te Kryetarit caktohet Komisioni i vleresimit te ofertave per kete prokurim

Njesia e Prokurimit, bazuar ne dokumentat standarte te miratuara nga APP harton dokumentacionin ligjor, ekonomik, financiar dhe teknik ku u perfshine dhe kerkesat per kualifikim te operatoreve ekonomike. Dokumentacioni i pergatitur, se bashku me formularin e njoftimit te kontrates dergohet ne forme elektronike prane APP, e cila ben publikimin ne faqen zyrtare www.app.gov.al dhe ne buletin e prokurimeve publike.

Bashkia Lezhë pritet të kryejë prokurimin online sapo të miratohet financimi nga DLDP. Në momentin e shpalljes së fituesit nga ana e Bashkisë Lezhë lidhet kontrata dhe fillohen punimet nga kompania fituese. Nje kopje e kesaj kontrate dergohet ne zyrën e Dldp ne shkodër.

Në këto tre vitet e fundit janë bërë edhe prokurime të tjera të kësaj natyre nga Bashkia Lezhë si:Rikonstruksion i zyrve te bashkisë,Rikonstruksion i Qendrës së Riciklimit,Sistemime në Lagjen “Gurra”,Rruga në Lagjen “Nënë Tereza” dhe Rruga Spital-Gurra etj. Nje kopje e kesaj kontrate dergohet ne zyrën e Dldp ne shkodër.

8 Buxheti I projektit (jo më tepër se 2 fq.)

Vlera totale e projektit	62157 €
Buxheti i kërkuar nga dldp	39999 €
Buxheti i kontribuar nga NJQV-ja	22158 €

Çmimet janë referuar manualeve standarte të cmimeve të miratuar të vitin 2010, (manuali 2 dhe manuali 3)aktualisht në fuqi. Për zërat e punimeve të reja janë bërë analiza teknike përkatëse. Preventivi është llogaritur sipas projektit teknik të realizuar, dhe në përputhje me matjet faktike të kryera në vend nga specialist të zyrës së urbanistikës.

Gjelbërimi nuk përfshihet në preventivin e punimeve të projektit pasi do të mbulohet nga Departamenti i Shërbimimeve Publike dhe në buxhetin e bashkisë ka zë të vecantë për gjelbrimin. Në total për gjelbërimin është parashikuar shuma: **13,900 Lekë për vitin 2012**(bashkangjitur do te gjeni Pasqyren Përmbledhëse te Shpenzimeve të Projekt-Buxhetit 2012)

9 Rreziqet/Supozimet (jo më tepër se 0.5 fq.)

Bashkia Lezhë nuk parashikon ndonjë rrezik të mundshëm për mos zbatimin e projektit, pasi mjedisi është aset i bashkisë. Ne supozojmë qendrimet indiferente të një grupi të rinjsh në aktivitetet sensibilizuese, por Bashkia Lezhë do të marrë të gjitha masat me specialistë të mirë të fushës, që këto aktivitete të jenë kreative dhe më elementare argetues dhe tërheqës për grupin e targetuar në projekt.

10 Plani i montorimit dhe i vlerësimit (jo më tepër se 0.5 fq.)

Cdo faze e projektit është një objektiv specifik në vetvete, dhe realizimi në rastin tonë është i matshëm dukshëm fizikisht si: muri rrethues, ndriçimi dhe mjedisi i gjelbër dhe sportiv ku do të monitorohet hap pas hapi nga specialistë të bashkisë Lezhë me vizita në vend.

Ndërsa pjesa ndërgjegjësuese e projektit për mirëmbajtjen dhe kundër fenomeneve negative të shfaqura në komunitetin e nxënësve dhe stafeve pedagogjike që ndajnë të njëjtin mjedis do të matet me pyetësor dhe intervista direkte me përfituesit.

Gjithë procesi do të monitorohet nga drejtoria e Programim Zhvillimit si dhe do të raportohet periodikisht tek donatori, këshilli bashkiak si dhe departamentet e tjera të bashkisë. Kjo drejtori do të mbaje lidhje të ngushta për monitorimin e procesit me faktorët formal si: Policia e Rendit/Antidroga/Antitrafikimi/Shëndeti Parësor/Drejtoria Arsimore, dhe faktorët informal: vetë komuniteti nxënës e mësues, rojet e portave, prindër, Parlament Rinor. Duke u bazuar në të dhënat e një krahasimi vlerësues mbështetur në raporte dhe statistika zyrtare lidhur me numrin e fenomeneve negative në këtë mjedis, pas përfundimit të projektit.

Ne fund stafi i menaxhimit të projektit do të plotësojë rreth 50 pyetësor mbi kënaqësinë e komunitetit për projektin e zbatuar me përfituesit. Raporti i të dhënave të pyetësoreve do të pasqyrohet në raportin narrativ për donatorin.

11 Qëndrueshmëria e projektit (jo më tepër se 2 fq.)

Ky projekt do të ketë impakt të drejtpërdrejtë në përmirësimin e infrastrukturës sociale dhe do të përmirësojë imazhin e shërbimit të bashkisë ndaj komunitetit për rritjen e cilësisë së jetës. Bashkia Lezhë në bashkëpunim me grupet e interesit do të marrë të gjitha masat për qëndrueshmërinë dhe funksionimin real dhe të ndjeshëm në komunitet të projektit me një plan veprimi të detajuar:

1. Departamenti i Shërbimeve Publike do të ngarkohet për mirëmbajtjen fizike të murit rrethues, ndriçimit, mjedisit të gjelbër dhe atij sportiv. Kjo drejtori do të propozojë shifrat për zërat e buxhetit që mbulojnë mirëmbajtjen e murit rrethues, ndriçimit, gjelbërimit dhe ambientit sportiv.

2. Drejtoria e Arsim Kulturës, Turizmit dhe Sportit do të jetë përgjegjëse për hartimin e planeve të aktiviteteve sportive në bashkëpunim me shkollat përkatëse dhe do të kujdeset për organizimin e tyre. Gjithashtu kjo drejtori do të jetë lider në kordinimin e punës midis Drejtorisë Rajonale të Arsim, Drejtorinë Rajonale të Policisë, Drejtorinë Rajonale të Shëndetit Parësor si dhe NGO-të për organizimin e vazhdueshëm të fushatave sensibilizuese kundër duhanit, drogave, trafikimit njerëzor, konflikteve dhe sherreve banale midis djemve dhe vajzave të shkollave përfituese nga ky projekt.

3. Drejtoria e Shërbimit Social do të jetë përgjegjëse për hartimin dhe kordinimin e aktiviteteve në bashkëpunim me shoqatën e të verbërve dhe atë Shpresë për të Varfërit, Romët e Veriut etj. Kjo drejtori

do të asistojë me ndihmë konkrete për inkurajimin dhe përfshirjen e tyre në aktivitete të planifikuara dhe organizuara në këto mjedise.

5. Drejtoria e Financës do të planifikojë zëra në buxhet që të mbulojnë gjithë veprimtaritë me karakter masiv, propozuar nga drejtoritë përgjegjëse.

Në buxhetin e Bashkisë janë planifikuar çdo vit shpenzime për mirëmbajtjen dhe riparimin e objekteve të institucioneve arsimore, sociale dhe kulturore. Konkretisht në tre vitet e fundit janë shpenzuar bazë materiale për riparimin e shkollave të qytetit, si më poshtë;

Në vitin 2009 3 150 000 lekë

Në vitin 2010 2 568 000 lekë

Në vitin 2011 2 875 000 lekë

Në vitin 2012..... 3 500 000 lekë miratuar në buxhet (shiko **Anex 2 nën Siprmarrjet pika a**)

Përveç bazës materiale të blerë, ka punuar brigada e shërbimit të Bashkisë për 2 muaj (korrik – gusht).

Me një kosto prej 112 000 lekë çdo vit.

Në vitin 2011, Bashkia, në kooperim me biznesin në qytet, ka kryer një rrethim provizorë të mjediseve të shkollave me një vlerë prej 5 000 000 lekë.

Në 5 vitet e ardhshme do të parashikohen:

Nr.	Zërat në buxhet	2013	2014	2015	2016	2017
1.	Mirëmbajtja e murit rrethues	25.000	30.000	30.000	30.000	35.000
2.	Gjelbërimi	50.000	50.000	50.000	50.000	50.000
3.	Mjedisi sportiv	32.000	35.000	35.000	35.000	35.000
	Totali:	107.000	115.000	115.000	115.000	120.000

6. Drejtoria e Programin Zhvillimit do të monitorojë procesin dhe do të përgatisë raporte për eprorët. Gjithashtu kjo drejtori do informojë komunitetin për çdo aktivitet këtu duke përdorur të gjitha format: Web, FB si dhe median lokale.

12 Faktorët cilësorë (jo më tepër se 2 fq.)

a) Aspektet gjinore.

Ky projekt është i ndjeshëm ndaj çështjeve gjinore dhe mundëson përfitim direkt pothuajse të barabartë për gra/vajza dhe burra/djem të komunitetit që jeton në atë mjedis.

Numri total është 3161 nga ku 1628 janë gra dhe vajza dhe 1522 burra dhe djem si dhe Paramenti Rinor me 35 anëtarë të zgjedhur nga shkollat e qytetit, Qeveritë e Nxënësve të shkollave në kompleks.

Gjatë zbatimit do të konsultohen direkt gratë dhe vajzat përfituese me takime formale dhe informale.

Ky projekt do të ndikojë në përmirësimin e cilësisë së jetës të të gjithë komunitetit të lartpërmendur, përfshirë rritjen e sigurisë së jetës së tyre dhe aksesin në veprimtari dhe kalim të kohës së lirë në mjedisin e brendshëm të përmirësuar në infrastrukturë si ndriçim, gjelbërimi, dhe sportive. Muri rrethues do të ketë impakt të drejtpërdrejtë në sigurinë e jetës .

Duke qënë se Lezha nuk mundëson veprimtari sportive të mirëfillta për gra dhe vajza, ky projekt do të ndërgjegjësojë këtë target grup për të planifikuar dhe inicuar aktivitete të ndryshme si Grupe voleybolli, basketbolli dhe bashkia do të alokojë zëra në buxhet që do të mbulojnë aktivitetet sportive të të gjithë të rinjve duke këmbëngulur për grupe të gjinive të ndryshme. Dhe kemi bindjen se 50% e grave dhe vajzave që ndajnë këtë mjedis të përbashkët do të përfitojnë direkt nga veprimtaritë të planifikuara që do të zhvillohen aty. Në fushatën sensibilizuese kundër fenomeneve negative si konfliktet, përdorimi i

lëndëve narkotike, rriskimi për trafikim njerëzor gratë dhe vajzat përfituese direkt do të jenë pjesmarrëse në çdo aktivitet për këtë qëllim.

b) Transparenca gjatë zbatimit.

Çdo fazë e projektit do të jetë në transparencë të plotë për komunitetin duke përdorur të gjitha format e informacionit, median lokale, faqen e Webit dhe gjithashtu takime direkte me grupet e interesit. Drejtorite e shkollave dhe komuniteti i nxënësve dhe mesuesve janë përfshirë në dizejnimin e projektit si dhe do të jenë të pranishëm në zbatimin e projektit, qoftë dhe në procesin e monitorimit dhe në procesin e mirëmbajtjes, ato do të jenë partner i rëndësishëm i bashkisë dhe do të mbështesin me plan veprimi konkret. Mjedis sportiv do të shfrytëzohet jo vetëm për aktivitete sportive në mes shkollash, por edhe në kryerjen e shumë temave të procesit të edukimit fizik përfshirë në korrikulën mësimore, për shkollat që nuk kanë palestra.

Gjithashtu duhet të theksojmë që ky mjedis do të jetë i aksesueshëm për aktivitete nga grupe të tjera jashtë shkollave, si grupi i futbollit (Shoqata e të verbërve), grupi i të rinjve Egjiptian & Rom(Shoqata Shpresë për të Varfërit) si dhe aktivitete të tjera të planifikuara nga Parlamenti Rinor, Lezhë

c) Inovacioni. Nëse ka kuptim (mund ta lini këtë seksion bosh) shpjegoni nëse idea e projektit tuaj apo metoda e zbatimit apo teknologjia e planifikuar të përdoret sjell një qasje të re në NJQV-në apo më gjerën në Qarkun tuaj dhe se ka mundësi që kjo ide/metodë të përdoret me sukses në të ardhmen.

13 Të dhëna rreth aplikantit (ëve) (jo më tepër se 2 fq.)

Bashkia Lezhë është njësi vendore qëndër Qarku e krijuar që nga korriku i vitit 1992 dhe përfshin vetëm qytetin (pa fshatrat përreth) me një popullsi prej 29002 banorë (dhjetor 2011, marrë nga zyra e gjëndjes civile, Bashkia Lezhë). Në këtë qytet funksionojnë disa institucione publike, të arsimit, kulturës, historisë, të administratës shtetërore etj.

Bashkia Lezhë administron një zonë urbane prej 275 ha, në të cilën shtrihen katër lagje, nga të cilat tre janë të hershme (Besëlidhja, Skënderbeg & Varosh), ndërsa njëra lagje ("Nene Tereza") është krijuar pas viteve 90, me banorë të ardhur nga zona malore e rrethit të Lezhës dhe ajo verilindore.

Në qytetin e Lezhës aktualisht janë ngritur dhe funksionojnë 6 shkolla nga të cilat 2 janë të mesme. Janë në ndërtim edhe dy shkolla të reja me fonde të BB dhe Qeverisë Shqiptare, njëra nga të cilat është e mesme.

Tregtia dhe ndërtimi janë aktivitetet kryesore të biznesit që janë ndërmarrë në vitet e fundit. Sektori i transportit dhe disa biznese prodhuese janë ato më kryesorët dhe që po zhvillohen gradualisht. Më shumë se 50 për qind e popullsisë është aktive dhe e aftë për punë. Përveç kësaj, ka një numër mjetesh të zhvilluara të transportit. Autostrada Tiranë–Shkodër, autostrada e planifikuar Durrës–Kosovë e cila do të kalojë nga Lezha, linja hekurudhore veri–jug, porti detar i Shëngjinit dhe Aeroporti i Gjadrit (aktualisht një pistë ajrore ushtarake) do të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të vendit. Përveç turizmit dhe agrobiznesit, një sektor tjetër që mund të kontribuojë në zhvillimin ekonomik të qytetit është industria e ndërtimit. Në afërsi të Lezhës ka rreth 140 subjekte juridike dhe 500 subjekte fizike, ose biznese të vogla ku përfshihen më shumë se 40 firma ndërtimi, 65 firma eksport-importi, 20 firma prodhuese, pesë kompani të përbashkëta (joint-ventures) dhe disa kompani peshkimi.

Bashkia Lezhë ka në përbërjen e saj 153 punonjës nga të cilët:

- Administrata e Bashkisë përbëhet nga 65

- Institucionet vartëse kanë 70 punonjës dhe
- Sektori i Shërbimeve Publike ka 18 punonjës

Në administratën e Bashkisë hierarkia është e tillë:

- a. Kryetari i Bashkisë
- b. Zv/ Kryetari i Bashkisë
- c. Sekretari i Përgjithshëm + Sekretari i Këshillit të Bashkisë
- d. Drejtoritë të cilat janë 9 (nëntë)
- e. Sektor dhe zyra janë 5 (pesë)
- f. Specialist që janë 47 (dyzet e shtatë)

Të gjitha institucionet vartëse dhe sektori i shërbimeve varen nga drejtoritë përkatëse

Buxheti i Bashkisë për 3 vitet e fundit:

Viti	Buxheti total	Të ardhurat e veta
2008	326 241	120 516
2009	328 003	122 711
2010	423 066	126 203

- **Projekte të një natyre të ngjashëm me projektin e propozuar, zbatuar gjatë tre viteve të fundit :**

Donatori	Titulli projekti dhe një përshkrim i shkurtër	Buxheti	Data e fillimit dhe e mbarimit
Qeveria e Shqipërisë dhe Partnerët e Zhvillimit - Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim (Banka Botërore), Banka Europiane e Investimeve dhe Banka për Zhvillim e Këshillit të Europës	Projekti për Cilësi dhe Barazi në Arsim	1895000 euro shkolla e mesme 1895000 euro shkolla 9-vjeçare	12.2009 - 12.2013

Bashkangjitur këtij dokumenti do të gjeni:

1. Konfirmim për bashkfinancim nga NJQV-së, bashkangjitur Pasqyren Permbledhese te Investimeve ne Projekt Buxhetin e vitit 2012, që konfirmon sasinë e parave të rezervuara për bashkëfinancimin e projektit, të paktën 20 % të vlerës totale të projektit. (projekti nuk është aprovuar akoma në Këshillin Bashkiak)
2. Licencën e projektuesit, projektin teknik e preventivi . (në rast investimi)
3. Vendimin e KRT-së që aprovon projektin. (në rast investimit)

Konfirmoj se informacioni i dhënë në dokumentet e këtij aplikimi është i saktë.

Sinqerisht,

VIKTOR TUSHAJ

Emri, Mbiemri, firma e titullarit të NJQV-së, vula e NJQV-së